



Njësia e auditimit të brendshëm

01Nr 016-PO702
Suharekë më 28.12.2022

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA REPUBLIC OF KOSOVO - MUNICIPALITY SUHAREKË			
MARRE NE DOREZIM - PIRHALJENO RECEIVED			
Nësi org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Broj Number	Shtesa Prilog Appendix	Vlera Vrijedost Value
01	016	PO702	2

PËR: Z. Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës
Z. Limon Morina, Kryesues i komisionit për auditim

NGA: Njësia për auditim të brendshëm, Ragip Kabashi Auditor

LËNDA: Dërgimi i planit vjetor 2023 dhe planit strategjik për periudhën 2023-2025

Bashkangjitur kësaj shkrese ua dërgojmë planin vjetor për vitin 2023 dhe planin strategjik për periudhën 2023-2025 përgatitur nga NJAB Komuna e Suharekës.

Sipas Ligjit mbi kontrollin e brendshëm të financave publike nr. 06L-021 neni 23 pika 1.2 miraton planet strategjike dhe vjetore të auditimit të brendshëm.

Plani vjetor dhe Strategjik është miratuar nga Kryetari i komunës dhe komiteti i auditimit. Planet vjetore dhe Strategjike trevjeçare nënshkruhen sipas praktikës së auditimit nga Kryetari i komunës dhe Kryesuesi i komitetit dhe auditori, planet dorëzohen në NJQHAB në Prishtinë.

Aprovimi i planit vjetor dhe strategjik është një nder parakushtet për ushtrimin e aktivitetit të pavarur të NJAB-it përkatësisht auditorit të brendshëm.

Me përshëndetje



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA –SUHAREKË
OPSTINA- SUVA REKA
MUNICIPALITY SUHAREKË



NJËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

PLANI STRATEGJIK

Për Njësinë e Auditimit të Brendshëm
në Komunën e Suharekës
për periudhën
2023-2025

Dhjetor 2022

PËRMBAJTJA:

I. Hyrje.....	4
1.1 Pasqyra.....	4
1.2 Struktura, funksionet dhe fushëveprimi i auditimit të brendshëm në Komunë.....	4
1.3. Azhurnimi i planit strategjik.....	5
II. TË KUPTUARIT E AKTIVITETEVE TË ORGANIZATËS.....	5
2.1. Qëllimet e Organizatës.....	5
2.2. Ndryshimet e pritura në organizatë.....	7
2.3. Niveli i kontrollit në organizatë.....	7
2.4. Struktura e organizatës, funksionet dhe ndërlidhjet në mes të njësive.....	8
2.5. Metodat për raportim dhe vendim-marrje.....	8
2.6. Rezultatet dhe dosjet nga auditimet e mëparshme.....	9
III. OBJEKTIVAT STRATEGJIK TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM.....	10
3.1 Objektivat kryesore.....	10
3.2. Objektivat kryesore të planit strategjik.....	10
IV. IDENTIFIKIMI I TË GJITHA SISTEMEVE TË AUDITUESHME.....	10
/UNIVERSI I AUDITIMIT/.....	10
V. VLËRËSIMI I RREZIKUT.....	12
5.1 Faktorët e rrezikut dhe rëndësia e tyre.....	12
5.2 Shkalla e gradimit të rrezikut.....	12
5.3 Kufijtë e Prioritizimit	12
5.4 Rezultatet nga vlerësimi i rrezikut.....	13
5.4.1 Procedurat e Prokurimit.....	13
5.4.2 Menaxhimi dhe regjistrimi i pasurisë në të gjithë organizatën buxhetore.....	17
5.4.3 Të hyrat nga tatimi në prone.....	19
5.4.4 Menaxhimi i shpenzimeve për të gjitha kategoritë e shpenzimeve për programet buxhetore –QKMF.....	22

5.4.5. Shpenzimet për të gjitha kategoritë e shpenzimeve në Drejtorinë Komunale të Arsimit..	25
5.4.6 Të hyrat jo tatimore participimet ne shëndetësi,administratën komunale Drejtorinë e shëndetësisë, palestrës sportive; taksave ne aktivitet te hyrat nga qiraja shkollat , tarifet për mësim për te rritur ne shkolla tarifet nga kadastra dhe gjeodezia te hyrat nga certifikatat diplomat nga shkollat si dhe te hyrat tjera jo tatimore	28
5.4.7 Menaxhimi i burimeve njerëzore.....	31
5.4.8. Menaxhimi i Automjeteve Zyrtare ne administratën komunale shëndetësi dhe arsim	35
5.4.9 Tabela e përkufizimit të faktorit të rrezikut.....	38
5.5.0 Rangimi i fushave të Auditimit sipas shkallës së rrezikut (prioritetizimi i fushave).....	39
5.5.1 PRAGJET E RREZIQEVE.....	39
VI. QASJA E AUDITIMIT.....	41
6.1 Shpeshtësia e auditimit.....	41
6.2. Kohëzgjatja e auditimit.....	41
6.3. Ndarja e detyrave për auditorë.....	42
VII .NDARJA E DETYRAVE PËR 2023, 2024, 2025. NË PAJTIM ME STRATEGJINË E AUDITIMIT DHE PËRCAKTIMI I DITËVE TË NEVOJSHME TË PUNËS PËR PERSON.....	44
VIII. MIRATIMI I PLANIT STRATEGJIK.....	46

I. HYRJE

1.1 Pasqyra

Ky plan strategjik prezanton objektivat kryesore, prioritetet dhe fushëveprimin e aktiviteteve të auditimit të brendshëm në Komunën e Suharekës për periudhën 2023 – 2025.

Plani strategjik është zhvilluar në bazë të vlerësimit të rrezikut dhe në pajtim me Ligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike (konkretisht Kapitulli III- Auditimi i Brendshëm), Standardet e Auditimit të Brendshëm, kodin e etikës së se auditorëve të brendshëm ,Statutin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Metodologjinë për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik, të përgatitur nga Njësia Qendrore Harmonizuese për Auditimin e Brendshëm.

Ky plan strategjik siguron bazat për zhvillimin e Planeve vjetore të aktiviteteve të auditimit të brendshëm të cilat do të përkufizojnë temën, fushëveprimin, objektivat dhe kërkesat e burimeve për implementimin e secilës detyrë të auditimit.

1.2 Struktura, funksionet dhe fushëveprimi i auditimit të brendshëm në Komunë

Funksioni i auditimit të brendshëm në organizatë realizohet nga NjAB e cila funksiononin e saj e ushtron duke u mbështetur në Ligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike (konkretisht Kapitulli III- Auditimi i Brendshëm), Rregulloren nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik,, statutin e NjAB-it.NjAB aktualisht përbëhet nga Udhëheqësi i NjAB-it.

Strukturimi dhe funksionimi i ardhshëm i Njesisë se auditimit të brendshëm do të bëhet në bazë të Ligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike 06/L-021. Aktualisht NJAB funksionon me udhëheqësin e auditimit dhe për të arritur objektivat e saja duhet që të ketë së paku edhe një(1) auditor të brendshëm i cili duhet ketë aftësi profesionale për tu kyçur në punët e auditimit në përmbushjen e planit strategjik 2023 – 2025.

Njësia e Auditimit të brendshëm është përgjegjëse për kryerjen e auditimeve të brendshme të të gjitha njësive strukturale, programeve, aktiviteteve dhe proceseve në organizatë sipas ligjeve në fuqi bazuar në metodologjinë e vlerësimit të rrezikut si dhe :

- *Auditimi i brendshëm ofron siguri të pavarur dhe objektive për udhëheqësin e subjektit të sektorit publik për përshtatëshmërin dhe efektivitetin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit ,si dhe ofron këshilla për përmirësimin e tij,*
- *Njësia e auditimit të brendshëm ushtron funksionin e saj në mënyrë të pavarur dhe I raporton drejtpërdrejt vetëm udhëheqësit të subjektit të sektorit publik (në rastin e komunave Kryetarit të Komunës) dhe e njofton Komitetin e Auditimit. Në raport me strukturat tjera organizative në subjektin e sektorit publik, Njësia për auditimin e brendshëm ka pavarësin funksionale në planifikimin e punës së auditimit, në kryerjen e auditimit dhe në raportim.*
- *Ndihmon Menaxhmentin e OB të jetë transparentë dhe llogaridhënës ndaj publikut, duke*

matur zbatimin e ligjit, udhëzimeve administrative, rregulloreve dhe kontrolleve të vendosura si dhe efikasitetin, ekonomizimin dhe efektivitetin e operacioneve

- *Ofron siguri objektive për të mbikëqyrur organet rreth besueshmërisë dhe kredibilitetit të raporteve të performancës dhe atyre financiare të përgatitura nga menaxhmenti, mund të ndihmoj menaxhmentin e Komunës të arrij qëllimet dhe objektivat e tija duke përmirësuar sistemet dhe shërbimet organizative*
- *Prezenca e rregullt e auditorëve mund të ndihmoj mbrojtjen e aseteve të komunës duke frenuar mashtrimin, humbjen dhe keqpërdorimin dhe*
 - *Kontributi nga auditimet mund të ndihmoj punonjësit që të përmirësojnë performancën e përgjithshme të punës dhe të zbatojnë kontrollet e vëna nga Menaxhmenti.*

1.3. Azhurnimi i planit strategjik

Ky plan strategjik duhet të rishikohet dhe azhurnohet çdo vit për të reflektuar çdo ndryshim që ndodhë në objektivat, prioritetet dhe aktivitetet e Komunës dhe në bazë të vlerësimit të rrezikut. Udhëheqësi i auditimit të brendshëm mund ta azhurnojë më shpesh planin strategjik sipas gjykimit të tij, sipas nevojës. Çdo ndryshim i Planit strategjik duhet të miratohet nga kryesuesi i organizatës buxhetore (Kryetari i komunes).

II. TË KUPTUARIT E AKTIVITETEVE TË ORGANIZATËS

NJAB ka filluar procesin e planifikimit strategjik duke bërë një rishikim të qëllimeve, njësive strukturale dhe aktiviteteve të organizatës. Rishikimi është bazuar në informacionet e grumbulluara përmes takimeve dhe intervistave me menaxhmentet e drejtorive komunale, zyrtarë të ndryshëm komunal, nga përgjigjet e tyre në pyetsorë, pastaj nga analizat e rezultateve të dalura nga auditimet e mëparshme, nga informacionet që ofrojnë qasje publike si dhe nga burime të tjera (Ligjet e aplikueshme të Kosovës që rregullojnë strukturën dhe aktivitetin e komunave).

Ky plan strategjik është i përpiluar në funksion të eliminimit të të gjitha shkaqeve që shpiejn kah mangësitë dhe lëshimet e konstatuara deri më tani.

2.1. Qëllimet e Organizatës

Qëllimet kryesore strategjike dhe operacionale të organizatës janë të përkufizuara me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës, strategjitë zhvillimore, planeve dhe programeve aktuale të aprovuara nga niveli lokal dhe qendror.

Komuna rregullon dhe udhëheq çështjet publike, brenda territorit të saj të përcaktuara me ligj, për të siguruar kushte për jetë normale dhe të qetë për të gjithë qytetarët. Komuna gjithashtu kujdeset për çështjet me interes të përgjithshëm, që ndërlidhen me Komunën dhe që nuk janë objekt shqyrtimi apo rregullimi të institucioneve qendrore apo të ndonjë organi tjetër jo të komunës.

Organet e Komunës së Suharekës, kujdesen që të gjithë qytetarët e komunës ti gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë pa dallim race, etnie, ngjyre, gjinie, gjuhe, religjioni, mendimi politik, apo mendimi tjetër, prejardhjes kombëtare apo sociale, pa dallim prone, lindje apo ndonjë statusi

tjetër me qëllim që ata të gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në shërbimet komunale në të gjitha nivelet.

Komuna ka kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijojnë:

- a) zhvillimin lokal ekonomik;
- b) planifikimin urban dhe rural;
- c) shfrytëzimin e tokës dhe zhvillimin;
- d) zbatimin e rregulloreve të ndërtimit dhe standardeve për kontrollimin e ndërtimit;
- e) mbrojtjen e mjedisit lokal;
- f) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin dhe drenazhin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale, transportit lokal dhe skemave të nxehtësie lokale;
- g) përgjigje ndaj rasteve emergjente lokale;
- h) ofrimin e arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e institucioneve edukative, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e instruktorëve dhe administratorëve të arsimit;
- i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut;
- j) ofrimin e përkujdesës publik primar shëndetësor;
- k) ofrimin e shërbimeve familjare dhe shërbimeve të tjera të mirëqenies sociale, siç është përkujdesi për të cënueshmit, strehimin familjar, përkujdesen fëmijor, përkujdesin për të moshuarit, duke përfshirë regjistrimin dhe licencimin e këtyre qendrave përkujdesëse, punësimin, pagesën e rrogave dhe trajnimin e profesionistëve të mirëqenies sociale;
- l) banimin publik;
- m) shëndetësinë publike;
- n) licencimin e shërbimeve publike dhe objekteve, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me argëtimin, aktivitete kulturore dhe të lira, ushqimin, strehimin, tregjet, shitësit në rrugë, transportimin lokal publik dhe taksitë;
- o) emërimin e rrugëve, rrugicave dhe vendeve të tjera publike;
- p) ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike;
- q) turizmit;
- r) aktivitetet kulturore dhe të lira;
- s) çdo çështje që nuk është përjashtuar shprehimisht nga kompetenca e tyre, apo që nuk i është përcaktuar një autoriteti tjetër;

Komuna ushtron kompetencat e deleguara nga autoritetet qendrore të Republikës së Kosovës, në pajtim me ligjin, me sa vijon:

- a) shënimet kadastrale;
- b) regjistrimin civil;
- c) regjistrimin e votuesve;
- d) regjistrimin e bizneseve dhe licencimin e tyre;
- e) distribuimin e pagesave të ndihmës sociale (me përjashtim të pensioneve);
- f) mbrojtjen e pyjeve, që ndodhen në territorin e Komunës, në kuadër të autorizimeve të deleguara, nga autoriteti qendror, duke përfshirë edhe dhënien e licencave për prerjen e druve, në bazë të rregullave të miratuara nga Qeveria.

Komuna do të ushtroj çdo kompetencë që do të bartet nga niveli qendror në periudhën e planifikimit strategjik 2023 – 2025.

Të gjitha këto kompetenca do të realizohen në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi të aprovuara në nivelin qendror dhe atij lokal.

Varësisht nga kompetencat, funksionet, qëllimin dhe natyra e punës së njësive buxhetore të komunës, këto zbatojnë edhe ligje tjera përkatëse të aprovuara nga Kuvendi i Kosovës.

Përveç zbatimit të ligjeve përkatëse në njësitë buxhetore, ato i zbatojnë edhe një mori udhëzimesh administrative të cilat i bien ministritë nga niveli qendror. Kuvendi Komunal ka të aprovuar Statutin e Komunës. Në bazë të nevojës dhe kompetencës për nevoja të njësive buxhetore dhe njësive shpenzuese brenda tyre Kuvendi Komunal ka aprovuar edhe rregullore të brendshme, si dhe plotësime të rregulloreve të cilat janë në fuqi.

Për realizimin e këtyre synimeve dhe objektivave nevojitet një qeveri lokale funksionale me staf profesional, një qeveri lokale që gjatë punës së vet ka për qëllim realizimin e parimit 3E (Efikasiteti, Efektiviteti dhe Ekonomizimi).

Andaj ndër objektivat kryesore strategjike të komunës janë:

- Krijimi i qeverisë lokale efikase dhe profesionale;*
- Mirëqenie më e mirë për qytetarët e komunës së Suharekës;*
- Realizimi i projekteve të ndryshme në të mirë të qytetarëve;*
- Përmirësimi i shërbimeve publike;*
- Rritja e kualitetit të shërbimeve arsimore me infrastrukturë adekuate dhe funksionale, gjithëpërfshirëse, të barabartë dhe duke e respektuar diversitetin në arsim;*
- Rritja e cilësisë dhe numrit të ngjarjeve kulturore dhe sportive me infrastrukturën e duhur institucionale, teknike dhe profesionale;*
- Ofrimi i shërbimeve kualitative shëndetësore dhe mirëqenies sociale;*
- Zbatimi i strategjive zhvillimore, planeve dhe programeve aktuale të aprovuara nga niveli lokal dhe qendror;*
- Hartimi strategjive zhvillimore, planeve dhe programeve të reja etj.*

2.2. Ndryshimet e pritura në organizatë

Gjatë periudhës 2023 – 2025 nga njësitë buxhetore në nivel të komunës priten veprime për dizajnimin kontrolleve të brendshme ma efikase me qëllim të përmbushjes së objektivave në nivelin e udhëheqjes së drejtorive. Përpos forcimit të kontrollit në menaxhimin e rrezikut për një performancë ma të mirë në raport me objektivave kyçe të njësive buxhetore mund të ketë ndryshime edhe në raste të vendimeve të organeve qendrore për marrje apo dhënie të kompetencave organeve komunale si dhe ndryshimit të legjislacionit nga niveli qendror.

2.3. Niveli i kontrollit në organizatë

Njësitë buxhetore të Komunës së Suharekës nuk ka objektiva të përkufizuara në mënyrë specifike lidhur me kontrollin e brendshëm por përgjegjësinë lidhur me kontrollin e brendshëm e ka deleguar tek Menaxhmenti i organizatave buxhetore dhe tek menaxhmenti i njësive shpenzuese.

2.4. Struktura e organizatës, funksionet dhe ndërlidhjet në mes të njësisë

Komuna e Suharekës në strukturën e vet organizative ka drejtor, sektorë, zyra të cilat janë të organizuara përmes këtyre drejtorive:

- Kabineti i Kryetarit,*
- Drejtoria e Administratës ,*
- Drejtoria e inspektionit,*
- Drejtoria për ekonomi financa dhe thesar ,*
- Drejtoria e Arsimit ,*
- Drejtoria e Kulturës, e Rinisë , Sportit dhe mërgatës ,*
- Drejtoria e Shëndetësisë dhe mirëqenie sociale ,*
- Drejtoria e Urbanizmit ,*
- Drejtoria e shërbimeve pronësoro juridike dhe Kadastër ,*
- Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjente,*
- Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ,*
- Zyra për Komunitete,*
- NJABI-i*
- Zyra për barazi gjinore dhe të drejtat e njeriut,*
- Zyra e personelit,*
- Zyra e prokurimit dhe –Zyra për integritet evropiane dhe*
- Qendra për punë sociale .*

2.5. Metodatat për raportim dhe vendim-marrje

Të gjitha njësitë qoftë për shpenzime apo për të hyra vetjake duhet të përgatitin raporte mujore, tre mujore, gjashtë mujore dhe vjetore.

Të gjitha të dhënat lidhur me të hyrat apo shpenzimet përgatiten dhe raportohen nga sektorët e drejtorive. Nga këto raporte drejtoritë përgatitin raporte me shkrim të cilat i shqyrtojnë dhe i raportojnë menaxhmentit të lartë të komunës.

Raportet tremujore, gjashtë mujore, nëntëmujore dhe vjetore të drejtorive analizohen dhe shqyrtohen në Komitetin për Politikë dhe Financa si dhe në Kuvend.

Sa i përket vendim-marrjes Kryetari i Komunës në bazë të kompetencave të përcaktuara me Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe me Statutin e Komunës merr vendime për çështjet madhore dhe me rëndësi për Komunën, kurse për çështjet organizative dhe teknike të drejtorive vendim marrin edhe menaxhmentet e drejtorive.

Për disa çështje vendimi merret edhe në Kuvendin Komunal konform Nenit 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.

2.6. Rezultatet dhe dosjet nga auditimet e mëparshme

Njësitë e programeve buxhetore të Komunës së Suharekës gjatë punës së tyre i nënshtrohen kontrolleve dhe auditimeve nga Zyra kombëtare e auditimit nga Njësia e auditimit të brendshëm si dhe nga organet tjera të nivelit qendror të autorizuara për kontroll të brendshëm dhe monitorimin për të siguruar cilësinë e sistemeve.

Zyra e Kombëtare e Auditimit bënë auditime të rregullta për çdo vit i cili auditim përfshinë të gjitha sistemet me rëndësi sa i përket shpenzimeve, të hyrave, menaxhimit të pasurisë dhe personelit në të gjithë organizatën buxhetore dhe pas Auditimit zakonisht jep një opinion lidhur me Pasqyrat Financiare të përpiluara nga Komuna me qëllim për të konstatuar se ato nuk përmbajnë keqinterpretime materiale.

Njësia e Auditimit brendshëm në bazë të planit vjetor të punës është e përqendruar në dhënien e sigurisë se ekziston dhe funksionon një kontroll funksional i cili është i dizajnuar dhe i cili mundëson që gabimet të gjenden dhe të korrigojnë me kohë, si dhe të gjitha aktivitetet dhe proceset janë në pajtueshmëri të plotë me kornizën ligjore në fuqi . Për të gjitha auditimet e mëparshme të kryera nga ana e NjAB-it janë përgatitur raportet të cilat i janë komunikuar menaxhmentit të lartë, komitetit të auditimit dhe NjQHAB në formë të raportimit periodik.

Njësia e Auditimit të Brendshëm ka bërë auditime në njësitë buxhetore sipas Planit Vjetor 2022 të bazuar në Planin Strategjik për periudhën 2022 – 2024.

Për të gjitha auditimet e mëparshme të kryera nga ana e Njesisë së Auditimit të Brendshëm janë respektuar procedurat për auditim sipas trajnimeve paraprake të organizuara dhe të mbajtura për auditim.

Në të gjitha auditimet në bazë të testeve të bëra janë gjetur të meta të sistemeve, për të cilat të meta janë dhënë rekomandime të bazuara në ligje, rregullore të nivelit qendror apo komunal si dhe në bazë të udhëzimeve administrative.

Gjatë verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna kemi vërejtur se në disa njësi buxhetore janë zbatuar më shumë e në disa më pak. Por ka edhe rekomandime të tillë që nuk janë zbatuar fare.

Për auditimet e bëra, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka përgatitur dosje të auditimit sipas procedurave përkatëse e cila është ruajtur në regjistrator të veçantë.

III. OBJEKTIVAT STRATEGJIK TË NJËSISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM

3.1 Objektivat kryesore

Çdo planifikim strategjik ne vete përmban objektivat kryesore të cilat kohë pas kohe duhet të rishikohet realizimi i tyre në praktikë.

Objektivat e planit strategjik janë:

- a) Reflektimi i objektivave strategjike të SSP në aktivitetet adekuate të AB;*
- b) Përcaktimi i “univerzitetit të auditimit” që përfshinë të gjitha fushat/aktivitetet në organizata të cilat mund t’i nënshtrohen auditimit të brendshëm;*
- c) Ofrimi i qasjes objektive bazuar në rrezik për përkufizimin e punës së auditimit të brendshëm;*
- d) Asistimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm në dhënien e sigurisë së arsyeshme mbi funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në organizatë;*

- e) Lejimi i NjAB-së që të optimizoj përdorimin e burimeve të saja dhe të përmirësoj efektivitetin e saj si shërbim për menaxhmentin;
- f) Prezantimi i standardeve dhe treguesve të cilët mund t'u ndihmojnë auditorëve të brendshëm në matjen e përparimit në punën e tyre dhe në arritjen e qëllimeve të veçanta strategjike; dhe
- g) Demonstrimi tek menaxhmenti se auditimi i brendshëm po kryhet në një mënyrë kompetente.

3.2. Objektivat kryesore të planit strategjik

Detyrat dhe aktivitetet specifike të NjAB (për secilin vit të mbuluar nga ky plan) të cilat reflektojnë këto objektiva strategjike do të prezantohen në planet vjetore të aktiviteteve të auditimit të brendshëm.

Në bazë të kuptuarit tonë të objektivave, prioritetëve, aktiviteteve dhe nivelit të kontrollit në organizatë gjatë periudhës 2023-2025, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka identifikuar objektivat strategjike në vijim:

- Përmirësimin e kontrollit të brendshëm të organizatës duke ofruar vlerësim objektiv dhe rekomandimet për përmirësim;
- Përmirësimin e të kuptuarit të funksionit të kontrollit të brendshëm;
- Përmes auditimit të performances trajtimi i temave të veçanta për të ndihmuar OB për të arrëtur objektivat.
- Të ndihmohet organizata që të formoj procesin për menaxhimin e rrezikut;
- Ngritjen e vetëdijes për menaxhimin e rrezikut në organizatë;
- Asistencë për zhvillimin e monitorimit në organizatë;
- Zhvillimi dhe arsimimi i vazhdueshëm profesional; dhe
- Menaxhimi i fondeve publike, etj.
- Pritjet nga Menaxhmenti i komunës për sigurimin e buxhetit të mjaftueshëm për rritjen e burimeve njerëzore me auditor të certifikuar dhe që kanë ngritje në karter të auditimeve të brendshme.

IV. IDENTIFIKIMI I TË GJITHA SISTEMEVE TË AUDITUESHME

/UNIVERSI I AUDITIMIT/

Universi i Auditimit është një listë gjithëpërfshirëse e të gjitha njësive potenciale të synuara për auditimin në Komunë, apo fusha e përgjithshme e aktivitetit të auditimit të brendshëm që ofron baza për planifikim afatmesëm.

Kjo nënkupton se nga të gjitha proceset që zhvillohen në të gjitha Drejtorit si dhe në zyrat nën përgjegjësin e Zyrës së Kryetarit, janë fushëveprim i auditimit të brendshëm, ndërsa renditja dhe prioritetizimi i tyre, duhet të bëhet varësisht nga niveli i vlerësuar i rrezikut .

Duke u bazuar nga doracaku i auditimit të brendshëm ku ekzistojnë tri qasje për caktimin e universit të auditimit të brendshëm.

Qasja funksionale –ndarja e sistemeve sipas funksionit të cilën ato e mbështesin dhe rolit të cilën ato e luajnë në kontrollin e brendshëm (sistemet monitoruese, sistemet operative, sistemet administrative-shërbyese).

Qasja strukturore – universi është ndarë në një numër relativisht të vogël të fushave të cilat përafërsisht korrespondojnë me skemën organizative të organizatës (drejtoritë, njësitë etj.).

Qasja e kombinuar –është e mundur të kombinohet divizioni i universit të auditimit në njësi strukturore me qasjen funksionale.

Duke e vlerësuar qasjen e tretë më praktike, Njësia e Auditimit të Brendshëm është bazuar në këtë qasje, me faktin se në komunën tonë ekzistojnë procese të cilat njëkohësisht lidhen me disa sisteme si psh. prokurimi, menaxhimi i kontratave nga menaxheret e caktuar dhe të autorizuar me vendim nga Menaxhmenti i komunes, pranimi i mallrave,menaxhimi i pasurisë, por edhe sisteme të cilat duhet të auditohen si njësi të ndara si psh. tatimi në pronë, menaxhimi i përdorimit të automjeteve,mbështetja financiare për OJQ dhe përcaktimi,kalkulimi dhe arketimi i të hyrave jo tatimore etj.

Njësia e Auditimit të Brendshëm për periudhën 2023-2025 ka bërë identifikimin e të gjitha sistemeve që do të auditohen gjatë periudhës 2023-2025. Ky identifikim i sistemeve është përcaktuar për qasje të kombinuar –funksionale dhe strukturore.

Njësia e auditimit të brendshëm për periudhën 2023-2025 ka bërë identifikimin e sistemeve që do të auditohen gjatë periudhës së lartë cekur

Për periudhën 2023-2025 janë identifikuar këto sisteme të cilat do të auditohen:

- *Prokurimi (shpenzimet kapitale për vlerat të mesme dhe të larta dhe menaxhimi i kontratave),*
- *Menaxhimi i pasurisë në të gjithë organizatën buxhetore,*
- *Të hyrat komunale nga tatimi në prone dhe të hyrave jo tatimore si taksave në aktivitet, qiratë për shfrytëzimin e objekteve komerciale dhe tokës ndërtimore etj;*
- *Të hyrat nga Drejtoria e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale të realizuara nga tarifat në sferën e shëndetësisë si tarifat nga vërtetimet,raportet konziliare të mjekëve për punëtorë në botën e jashtme si dhe tarifat tjera të përcaktuara në rregulloren komunale,*
- *Të hyrat nga dhënia e pronës komunale në shfrytëzim,*
- *Të hyrat administrative komunale;*
- *Shpenzimet për mallra e shërbime, komunalit dhe Subvencionet dhe transferet në administratën e përgjithshme, në drejtorin e Arsimit dhe të Shëndetësisë,*
- *Të hyrat nga participimi të realizuara nga biblioteka dhe palestra sportive,*
- *Të hyrat tjera komunale te realizuara ne Drejtorinë për urbanizëm,*

- Të hyrat e realizuar në Drejtorinë e pronës ,gjeodezi dhe kadastër,
- Të hyrat e realizuara nga tarifat për qëndrim ditor të fëmijëve në Çerdhe e fëmijëve që menaxhohen nga OB,
- Me kërkesë të veçanet nga Zyrtari Kryesor Administrativ(Kryetari i Komunës).
- Të hyrat e realizuar nga qiraja dhe dokumenteve tjera nga disa shkolla.
- Si dhe sistemet tjera në komunë.

V. VLËRËSIMI I RREZIKUT

5.1 Faktorët e rrezikut dhe rëndësia e tyre

Faktorët e rrezikut që vendosin për angazhimet me prioritet si: cilësia e kontrolleve të brendshme, kompleksiteti dhe madhësia e operacioneve; ndikimi financiar, koha e angazhimit të fundit të auditimit, rregullat ligjore ose kontraktuale, ndërrimet e fundit në aktivitet ose procesit, kompetenca e menaxhmentit, marrëdhëniet e punonjësit dhe qeverisë, lëvizja e personelit ndryshimet e aktiviteteve dhe strukturës së komunës, amendamentin i rregulloreve të brendshme, kompleksiteti i rregulloreve etj.

Varësisht nga përzgjedhja e faktorëve të rrezikut shuma e tërë faktorëve llogaritet me koeficientin 1 i cili shpërndahet në të gjithë llojet e rrezikut ndërsa shkalla e përlllogaritur për një rrezik paraqet faktorin e rrezikut .

Llojet e rrezikut

- Rreziku organizativ;
- Rreziku legjislativ;
- Rreziku strategjik;
- Rreziku i operimit;
- Rreziku financiar;
- Rreziku menaxherial;

Vlerësimi i drejtë i rrezikut është faktori dominant që garanton suksesin e auditimit. Hartimi i planit strategjik të bazuar në rrezik të vlerësuar profesionalisht është sigurues se objektivat e auditimit do të arrihen së bashku me objektivat e komunës.

5.2 Shkalla e gradimit të rrezikut

Me qëllim të vlerësimit sa më efikas të rrezikut nga literatura e auditimit janë përdorur teknikat e njohura për rangimin e niveleve të rrezikshmërisë shkalla e gradimit për faktorët e rrezikut në planin strategjik **2023-2025** do të jetë prej **1- niveli i ulët, 2-niveli i mesëm dhe 3-niveli i lartë i rrezikut** , përveç këtyre shkallëve të rrezikut, faktorët e rrezikut do të vlerësohen edhe për nga rëndësia e tyre, në mënyrë që të zgjidhet fusha e auditimit e cila ka një rrezikshmëri më të lartë dhe rëndësi më të madhe .

5.3 Kufijtë e Priorizimit

Njësia e auditimit të brendshëm do të bëjë priorizimin e fushave në bazë të vlerësimit të rrezikut në mënyrë që fushat ku na paraqitet rreziku i ulët do të vlerësohen me koeficientin 1, fushat me rrezik të mesëm do të vlerësohen me koeficient 2, ndërsa fushat me rrezik të lartë do të vlerësohen me koeficient 3 .

Sistemet me indeksin e rrezikut prej 2.31- 3.00 janë fusha me rreziqe të larta
Sistemet me indeksin e rrezikut prej 1.71-2.30 janë fusha me rrezik të mesëm
Sistemet me indeksin e rrezikut prej 1.00-1.70 janë fusha me rrezik të ulët

5.4 Rezultatet nga vlerësimi i rrezikut

Gjatë realizimit të objektivave të parapara Komuna e Suharekës e cila është organizatë buxhetore shfaqen edhe rreziqe të cilat paraqiten si pengesë e realizimit të objektivave nëpër programet buxhetore të komunës.

Andaj Menaxhmenti i këtyre programeve buxhetore duhet gjetur metoda për ta menaxhuar rrezikun. Ndër metodat për menaxhimin e rrezikut është edhe identifikimi i të gjitha rreziqeve të mundshme dhe caktimi i aktiviteteve të kontrollit brendshëm, e cila metodë është e zakonshme për zvogëlimin e ndodhjes apo ndikimit të rrezikut ndaj të cilave janë të ekspozuara organizatat buxhetore.

Njësia e auditimit të brendshëm gjatë auditimeve me një vlerësim të saktë të shkaqeve që mund të ndikojnë në paraqitjen e rrezikut, pas analizimit dhe vlerësimit të kontrollave se sa janë funksionale, apo jo tërësisht funksionale, jep rekomandimet përmes së cilave mund të i ndihmoj Menaxhmenteve të programeve buxhetore që gjatë përcaktimit të objektivave ta bëjnë ri vlerësimin e rreziqeve dhe pasojat e tyre si dhe mundësinë e zvogëlimit të ndodhjes apo ndikimit. Pas identifikimit të sistemeve apo entitete që do të auditohen, nga ana e njësisë së auditimit të brendshëm prioritet i radhës së kësaj njësie është ri vlerësimi i rrezikut për secilin sistem, i cili vlerësim do të mundësonte planifikimin e sistemeve të cilat do të mund të auditohen gjatë kësaj periudhe apo në vitin e ardhshëm .

Ri Vlerësimi i rrezikut paraprakisht është i duhur të bëhet nga ana e Menaxhmentit të lartë me qëllim të dizajnit të një sistemi adekuat të kontrollit të brendshëm, mirëpo në mungesë të këtyre vlerësimeve nga ana e Menaxhmentit edhe pse është përgatitur ne formë të shkruar lista e rreziqeve, Njësia e Auditimit të brendshëm me qëllim të hartimit të këtij plani strategjik mbi detyrat e auditimit të brendshëm në kuadrin e informatave që i disponon si dhe në bazë të gjeturave nga auditimet e kryera viteve të më hershme do të bëjë vlerësimin e rrezikut për çdo dhe çdo vit për çdo fushë të auditimit . Me faktin se është zgjedhur një qasje e kombinuar fushat e auditimit do të jenë në disa raste nga një procedurë e cila zhvillohet brenda një sektori të caktuar si psh prokurimi, apo një procedurë që kryhet në disa njësi të lidhura mes veti menaxhimi dhe regjistri i pasurive , menaxhimi i veturave, të hyrat etj,

Rreziqet paraqesin të gjitha devijimet dhe pengesat të cilat mund të shfaqen dhe të cilat kërcënojnë që objektivat kryesore të komunës në përgjithësi të kenë një performancë të padëshiruar.

Vlerësimi i rrezikut është kryer në rend të parë duke u mbështetur në faktorët e rrezikut në kategoritë kryesore të rrezikut, si dhe duke u mbështetur në gjasat e ndodhjes së këtyre faktorëve dhe duke graduar për nga rëndësia nëse një gjë e tillë mund të ndodhe në indeks prej 0.10 - 1.00.

5.4.1 Procedurat e Prokurimit

Prokurimi është njëra ndër shtyllat kryesore të shpenzimit të parave publike dhe një pikë shumë e rëndësishme e funksionimi të kontrollit të brendshëm, kështu që kryerja e procedurave të blerjeve ,kontraktimi i punëve , mallrave dhe shërbimeve kanë një rëndësi tejet të madhe nëse kryhen në përputhje të plotë me Ligjin mbi Prokurimin Publik të Kosovës nr 04/L-042, me ndryshim dhe plotësime LMFPP nr 03/L-048 , në mënyrë që menaxhimi financiar në Komunë të ketë një performancë të mirë dhe ligjet detyësore të miratuara nga KRPP-ja dhe prioritet me Rregulloren nr 01/2022 për prokurimin publik i cili ka hyrë në fuqi nga data 01.11.2022.

Kjo pa dyshim që arrihet me një angazhim sistematik duke u mundësuar të gjithë operatorëve pjesëmarrje përmes një transparence të plotë, duke insistuar në sigurimin e vlerave ekonomike për Komunën përmes blerjeve konkurruese.

Zyra e prokurimit i zhvillon procedurat duke filluar prej blerjeve me vlera minimale, koutimeve, vlerave të mesme dhe vlerave të mëdha për të gjitha programet buxhetore, andaj menaxhmenti duhet që të sigurohet se në këtë segment është vendosur një sistem i tillë i kontrollit i cili i mbulon të gjitha rreziqet të cilat mund ti pengojnë ne arritjen e objektivat kryesore të Komunës me faktin se nëse nuk janë mbuluar të gjitha rreziqet mund të ndikoj në humbjen e reputacionit të Komunës në përgjithësi.

Rreziqet gjatë udhëheqjes së procedurave te prokurimit mundë të jenë,transparenca,përgatitja e dosjes se tenderëve ne mënyrë favorizues,mos zhvillimi konkurrencës dhe përzgjedhja e operatoreve ma të përgjegjshëm në pajtueshmëri me rregullat e prokurimit.

Nr	Kategoria e rrezikut	Faktori i rrezikut	Gradimi	Rëndësia	Indeksi i rrezikut
1	Rreziku Organizativ		2.00	0,10	0.20
		Kuptimi i dobët i përgjegjësive të zyrtarëve që merren me procesin e prokurimit	2	0.02	0.04
		Mungesa e hapësirës së mjaftueshme për punë dhe kushteve të punës	2	0.01	0.02
		Mungesa e stafit te certifikuar	2	0.01	0.02
		Dosjet e prokurimit nuk përmbajnë dëshmitë se procedura e prokurimit është zhvilluar sipas kërkesave ligjore	2	0.01	0.02
		Mos mbajtja e trajnimeve në vazhdimësi për zyrtarët e prokurimit.	2	0.01	0.02

		<i>Mungesa e evidencave te sakta lidhur me prokurimit e kryera , kontrata e nënshkruara , pagesat e kryera dhe punët ne proces</i>	2	0.02	0.04
		<i>Mos raportimi nga Menaxheret për menaxhimin e kontratave lidhur me progresin e arritur dhe dobësitë dhe raportimi ne departamentin e prokurimit për procedura te mëtejme</i>	2	0.02	0.04
2	Rreziku legjislativ		3	0.20	0.60
		<i>Mos zbatimi i ligjit të prokurimit gjatë procedurave</i>	3	0.12	0.36
		<i>Kompleksiteti i ligjit të prokurimit</i>	3	0.05	0.15
		<i>Mos njoftimi me kohë për ndryshimet e ligjit</i>	3	0.03	0.09
3	Rreziku strategjik		3	0.15	0.45
		<i>Plani përfundimtar jo real i prokurimeve</i>	3	0.05	0.15
		<i>Mos realizimi i planit përfundimtar të prokurimeve për mallra,punë dhe shërbime</i>	3	0.06	0.18
		<i>Ndërrimet e shpeshta të projekteve – kontraktimi i punëve mbi vlerat e planifikuara me prioritet e aprovuara nga Asambleja Komunale</i>	3	0.04	0.12
4	Rreziku kontraktual		3	0.20	0.60
		<i>Ndryshimet e kontratave për të mundësuar operatorëve ekonomik pagesat sipas dëshirës</i>	3	0.04	0.12
		<i>Mos zbatimi i kushteve të parapara me kontratë për kryerjen e pagesës</i>	3	0.04	0.12
		<i>Mos sigurimi (garantimi) i kontratave në rast të mos kryerjes së punës.</i>	3	0.03	0.09

		<i>Aplikimi i Aneks kontratave, pasi që puna është kryer apo malli është marrë</i>	3	0.03	0.09
		<i>Raportet e pranimit të menaxherëve nuk pasqyrojnë drejtë punën që është kryer si dhe kohën e kryerjes së punëve</i>	3	0.03	0.09
		<i>Mos inicimi i procedurave gjyqësore për mos përmbushje të kontratës.</i>	3	0.03	0.09
5	Rreziku financiar		3	0.25	0.75
		<i>Projektet detale të punuara jo si duhet (në vete përfshijnë edhe pozicione të dyshimta të cilat mund edhe të mos kryhen)</i>	3	0.04	0.12
		<i>Nënshkrimi i aneks kontratave për çdo projekt</i>	3	0.03	0.09
		<i>Zëvendësimi i materialeve me dimensione me të vogla me ato që janë paraparë në paralogarit (gjerësia e pesetave, gypave, shtresa e gurit, asfaltit)</i>	3	0.04	0.12
		<i>Mbikëqyrja jo adekuate e realizimit të kontratave</i>	3	0.04	0.12
		<i>Tejkalim të vlerave të kontratave – me rastin e nënshkrimit të anekseve çmimet nuk përputhen me ofertën bazë</i>	3	0.03	0.09
		<i>Pagesa e e situacioneve nuk përputhen me punët e kryera në teren</i>	3	0.03	0.09
		<i>Pranimet teknike kryhen pa u përfunduar projekti 100%</i>	3	0.04	0.12
6	Rreziku menaxherial		2.83	0.10	0.28
		<i>Kuptimi i dobët i përgjegjësive nga ana e menaxhmentit lidhur me rolin e procedurave të prokurimit</i>	3	0,02	0.06
		<i>Menaxhimi i dobët i operatorëve në fazën e kryerjes së punëve si dhe dëshmitë e përcjelljes</i>	3	0,02	0.06

		<i>Mungesa e projekteve detale për punët që janë duke u kryer në vazhdim e sipër .</i>	2	0.02	0.04
		<i>Mos koordinim i punëve në mes ZKF dhe menaxherit të prokurimit lidhur me disponueshmërin e mjeteve për punët e publikuara</i>	3	0.01	0.03
		<i>Pas pranimit teknik ne pah dalin ankesat nga qytetaret për mosfunksionimin e projekteve te financuara</i>	3	0.01	0.03
		<i>Ankesat në OSHP si dhe procese të vazhdueshme hetimore për kontraktimet e dyshimta</i>	3	0.02	0.06
				1.00	2.88

5.4.2 Menaxhimi dhe regjistrimi i pasurisë në të gjithë organizatën buxhetore

Njëra ndër objektivat e menaxhmentit është edhe ruajtja dhe menaxhimi i pasurive me të cilat disponon OB, kur kemi parasysh faktin se Komuna e Suharekës ka një pasuri të mjaftueshme të pasurisë jo financiare kapitale dhe jo financiare dhe jo kapitale (Inventari me jetë gjatësi më shumë se një vjet, duke filluar nga tokat komunale, objektet të cilat janë pasuri e komunës, objektet shkollore, objektet shëndetësore, automjete zyrtare, inventar, TI etj .

Për të mbuluar të gjitha rreziqet në këtë segment duhet vendosur një sistem të tillë të kontrollit i cili mundëson që të gjitha rreziqet për humbje apo tjetërsimin e këtyre pasurive janë të mbuluara mirë dhe se është siguruar një monitorim i mirëfilltë për regjistrimin, ruajtjen dhe menaxhimin e tyre.

Rreziqet cilat mund të identifikohen në këtë fushë kanë të bëjnë me:

Regjistri jo i plotë për pasurit jo financiare dhe jo kapitale si rrjedhojë e pranimeve të donacioneve dhe projekteve me bashkëfinancim pa raporte financiare që rezultojnë ne mos integrim te plotë të pasurive kryesisht pasurit e shkollave në sistemin e pasuria etj .

Nr	Kategoria e rrezikut	Faktori i rrezikut	Gradimi	Rëndësia	Indeksi i rrezikut
1	Rreziku organizativ		2.00	0.10	0.20
		<i>Mungesa e zyrtarëve për regjistrimin e pasurive</i>	2	0.02	0.04
		<i>Mungesa e inventarizimit të pasurisë një herë në vit</i>	2	0.02	0.04
		<i>Kuptimi i dobët i përgjegjësive nga ana e zyrtarit të pasurive</i>	2	0.02	0.04

		<i>Mungesa e regjistrave të pasurisë ,dhe mos azhurnimi i shënimeve të reja</i>	2	0.02	0.04
		<i>Mos mbajtja e trajnimeve në vazhdimësi për zyrtarët e pasurive.</i>	2	0.01	0.02
		<i>Mos azhurnimi i të dhënave nga ana e zyrtarit të pasurive , për blerjet , largimin e pasurive të dëmtuara , shitjen e tyre etj</i>	2	0.01	0.02
2	Rreziku legjislativ		3	0.20	0.60
		<i>Mungesa e udhëzimeve të qarta nga MEF për format e formularëve që duhet të përdoren në mënyrë unike për të gjitha OB</i>	3	0.05	0.15
		<i>Mungesa e procedurave te brendshme te shkruara për meanxhimin, regjistrimin e pasurive dh trajtimin e zërave te pasurive</i>	3	0.05	0.15
		<i>Tjetërsimi i pasurive behet ne kundërshtim me rregulloren dhe procedurën e menaxhimit te pasurive</i>	3	0.05	.015
		<i>Mungesa e masave për veprim për harmonizimin e gjendjes se konstatuar nga komisioni për Inventarizim për çregjistrimin e pasurive te cilat nuk ekzistojnë</i>	3	0.05	0.15
3	Rreziku strategjik		2.4	0.15	0.36
		<i>Mungesa e evidencave gjithëpërfshirëse të gjitha pasurive që disponon komuna</i>	3	0.02	0.06
		<i>Mungesa e informatave për pasurit e blera në programet buxhetore nëpër vite</i>	3	0.03	0.09
		<i>Mos sigurimi i kushteve për ruajtën e pasurisë kapi-tale, jo kapitale dhe inventarit nga humbjet, dëmtimi, zjarri,vërshimet,uji etj.</i>	2	0.03	0.06
		<i>Humbja e pasurive për shkak te mungesës se kontrollit te brendshëm</i>	2	0.02	0.04
		<i>Menaxhim jo efikas</i>	2	0.05	0.10
4	Rreziku kontraktual		2.47	0.20	0.49
		<i>Pasurit kapitale, jo kapitale dhe inventar</i>	3	0.05	0.15

		<i>„pranohen me një cilësi të dobët</i>			
		<i>Mos furnizimi adekuat me pasuri kapitale, jo kapitale dhe inventarit sipas kushteve të parapara me kontratë.</i>	3	0.05	0.15
		<i>Mos përmbushja e kontratave nga ana e operatorit ekonomik sipas kushteve të përcaktuara</i>	2	0.05	0.10
		<i>Mos inicimi i procedurave gjyqësore për mos përmbushje të kontratës.</i>	2	0.05	0.10
5	Rreziku financiar		3	0.25	0.75
		<i>Mungesa fizike e pasurive të regjistruara</i>	3	0.05	0.15
		<i>Blerjet jo ekonomike të pasurive me çmime jo të arsyeshme</i>	3	0.05	0.15
		<i>Pagesa e shpenzimeve të TI , ku kontratat afatgjate nuk përputhen me trendët e rënies së çmimeve për pajisjet e TI</i>	3	0.05	0.15
		<i>Shitja e pasurive kapitale, jokapitale dhe inventarit të panevojshëm nën vlerën e tyre</i>	3	0.05	0.15
		<i>Mungesa e evidencës së saktë</i>	3	0.05	0.15
6	Rreziku menaxherial		2.8	0.10	0.28
		<i>Kuptim i jo i qartë i përgjegjësive nga menaxhenti për menaxhimin e pasurive</i>	3	0.02	0.06
		<i>Sistem i dobët i menaxhimit informativ – mungesë e raportimit dhe njoftimeve me kohë për ndryshimet në pasuri</i>	3	0,02	0.06
		<i>Mbikëqyrja jo e mjaftueshme dhe jo adekuate</i>	2	0.02	0.04
		<i>Mungesa e informatave për pasurit e luajtshme dhe të paluajtshme</i>	3	0.02	0.06
		<i>Pasqyrat vjetore Financiare te Komunës ,vazhdimisht potencojnë se regjistrat e pasurive nuk janë gjithë përfshirës</i>	3	0.02	0.06
				1.00	2.68

5.4.3 Të hyrat nga tatimi në prone

Të hyrat e tatimit në pronë janë të hyrat të cilat grumbullohen nga sektori i tatimit në pronë. Ky sektor është në kuadër të Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa, e cila Drejtori bënë pjesë në kuadër të organizatës buxhetore të administratës komunale.

Këto të hyra përbëjnë pjesën më të madhe të hyrave të përgjithshme komunale. Të hyrat e tatimit në pronë grumbullohen nga tatimi i pronave për banim, rezidenciale, komerciale, industriale, bujqësore, të braktisura dhe të pa banuara në bazë të Ligjit mbi tatimin në pronën e paluajtshme, Rregulloreve komunale mbi Tatimin në Pronë dhe udhëzimin e MFE për ndalimin e shërbimeve komunale për qytetarët të cilat nuk kanë paguar Tatimin në pronë .

Duke pasur parasysh se buxheti komunal i cili financohet nga burimet vetjake e ka këtë burim të hyrave si dhe faktin se të gjitha këto të hyra përsëri investohen në përmirësimin apo ndërtimin e infrastrukturës përmes investimeve kapitale, padyshim se në këtë sektor duhet një menaxhim të rrezikut, pasi që edhe vendimet për investime kapitale varen nga shkalla arkëtimit të këtyre të hyrave. Rreziqet në këtë sektor të rëndësishëm kanë të bëjnë me pengesat e arkëtimit të shumës së paraparë , mbledhjes me kohë, mos përfshirjen e të gjithë obliguesve të mundshëm në faturim , paraqitjen jo reale të objekteve, mos azhurnimin e të dhënave nga ana e komisionit anketues për evidentimin e objekteve të cilat janë ndërtuar dhe shfrytëzohen ndërsa ne këtë sektor figurojnë si objekte të pa ndërtuara , qasjet e pa autorizuara ne sistemin e të dhënave të tatimit në pronë etj. Kështu që ne bazë të këtyre rreziqeve duhet të funksionoj një sistem i kontrollit të brendshëm i cili me kohë i vëren dhe korrigjon të gjitha gabimet të cilat mund të paraqiten.

Nr	Kategoria e rrezikut	Faktori i rrezikut	Gradimi	Matja relative	Indeksi i rrezikut
1	Rreziku organizativ		1.8	0.10	0.18
		<i>Kuptimi i dobët i përgjegjësive të zyrtarëve të cilët punojnë në sektorin e tatimit në pronë</i>	2	0.02	0.04
		<i>Mungesa e hapësirës së mjaftueshme për punë</i>	1	0.01	0.01
		<i>Mungesa e kushteve për ruajtjen e dosjeve të kryera të tatimit në pronë</i>	2	0.03	0.06
		<i>Mungesa e mjeteve për punë(automjet, fotokopjues, kompjuter,kamerë, fotoaparate etj).</i>	2	0.03	0.06
		<i>Mos mbajtja e trajnimeve në vazhdimësi për zyrtarët që merren me procesin e tatimit në pronë.</i>	1	0.01	0.01
2	Rreziku legjislativ		2.9	0.20	0.58
		<i>Mos zbatimi i rregulloreve të tatimit në pronë</i>	3	0.04	0.12

		<i>Kompleksiteti i rregulloreve të tatimit në pronë</i>	3	0.04	0.12
		<i>Zbrastirat juridike në rregulloren mbi tatimin në pronë</i>	2.5	0.04	0.10
		<i>Mos harmonizimi i rregullores komunale me rregulloren nga niveli qendror.</i>	3	0.04	0.12
		<i>Mos zbatimi i udhëzimeve administrative</i>	3	0.04	0.12
3	Rreziku strategjik		2.6	0.15	0.39
		<i>Mos evidentimi i të gjitha pronave ekzistuese</i>	3	0.04	0.12
		<i>Mos verifikimi i 1/3 së faturave të lëshuara sipas ligjit</i>	2.75	0.04	0.11
		<i>Shënimet e pandryshuara për shumë vite për objektet e papërfunduara ,edhe pse në realitet ato janë përfunduar</i>	2.5	0.04	0.10
		<i>Dështimi në grumbullimin e të hyrave nga tatimi në pronë</i>	2	0.03	0.06
4	Rreziku i operimit		2.50	0.20	0.50
		<i>Lirimi nga tatimi në pronë për kategorinë që nuk janë të liruara me rregullore apo udhëzime administrative</i>	2	0.04	
		<i>Fshirja e obligimeve të tatimpaguesve ,nga ana e zyrtarëve pa u kryer obligimet</i>	3	0.05	
		<i>Ndërhyrja e menaxhmentit dhe e zyrtarëve të organizatës për ndryshimin e koeficientit,zonës tatimore të tatimit në pronë për disa obligues pa mbështetje ligjore.</i>	2	0.05	
		<i>Aplikimi i tarifave të reja për tatimin në prone të pa aprovuara nga niveli qendror.</i>	3	0.06	
5	Rreziku financiar		2.42	0.25	0.605
		<i>Mos faturimi i të gjithë obliguesve potencial.</i>	3	0.04	0.12
		<i>Mos shpërndarja faturave</i>	3	0.03	0.09
		<i>Zvogëlimi i shkallës së inkasimit dhe rritja e borxheve</i>	3	0.04	0.12

		<i>Mungesa e të hyrave si rezultat i ndryshimeve të pa autorizuara në bazën e të dhënave</i>	2.6	0.05	0.13
		<i>Kalkulim jo korrekt i tatimit në pronë.</i>	1	0.04	0.04
		<i>Mos shqyrtimi i ankesave</i>	2	0.03	0.06
		<i>Mos ndryshimi i bazës tatimore , dhe mos regjistrimi i lartësisë së tatimit pas shqyrtimit të ankesave</i>	2	0.02	0.04
6	Rreziku menaxherial		2.6	0.10	0.26
		<i>Shpërndarja jo adekuate e resurseve njerëzore</i>	3	0.02	0.06
		<i>Mungesa e evidencave ,dhe raporteve kualitative</i>	2	0.02	0.04
		<i>Mbikëqyrja jo e mjaftueshme dhe jo adekuate</i>	3	0.02	0.06
		<i>raportimi jo i saktë dhe analizave krahasuese për të hyrat e tatimit në pronë.</i>	2	0.02	0.04
		<i>Mos zbatimi i rekomandimeve nga auditimi paraprak</i>	3	0.02	0.06
				1.00	2.52

5. 4.4 Menaxhimi i shpenzimeve për të gjitha kategoritë e shpenzimeve për programet buxhetore -QKMF

